



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:062020

Datë: 28.08.2020

Numri i dokumentit: 01081152

**P.nr. 1023/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin Alban Ajvazi, me bashkëpunëtoren profesionale Kristina Shtufi, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.A., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore nga Prishtina, PP.II.nr.1759/2020, të dt.28.05.2020, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrat ndëshkimor: dënim me gjobë, me datë 28.08.2020, mori:

### **A K T G J Y K I M**

Pranohet Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.1759/2020, të dt.28.05.2020, gjykata jep këtë:

### **URDHËR NDËSHKIMOR**

**I akuzuari: N.A.**, nga i ati N., i lindur me datë ..., në Obiliq, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Për shkak se:**

I pandehuri, me datë 12.05.20 ë pushur dhomën me numër 3 të motelit në fjalë, ku kishte qëndruar rreth gjysmë ore dhe se pasi kishte dal nga aty, me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme, e vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm me vete kishte marrë një tavolinë të cilën e kishte futur në veturën Golf ngjyrë e kaltër e mbylltë, me targa regjistrimi ..., dhe ishte larguar nga vendi i ngjarjes me ç'rast të dëmtuarit i kishte shkaktuar dëm material rreth 60 (gjashtëdhjetë)€.

**Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par 1 të KPRK-së,**

Andaj, gjykata konform neneve 7, 17, 38, 43, të KPRK, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, shqipton këtë:

### **DËNIM ME GJOBË**

I akuzuara **N.A.**, dënohet me gjobë në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)**, të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. 20, rreth orës 11:30 minuta në fshatin Sh. në Obiliq, më konkretisht në motelin "Sh.", pronë e të dëmtuarit A.K.dhe pasi që e kishte marrë në shfrytëzim, për t

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20€ të gjobës.

Obligohet i akuzuari që të paguajnë shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30€**, si dhe në emër të kompensimit të viktimave në shumë prej tridhjetë euro (**30**) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore–juridike, udhëzohet në kontest juridiko – civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP.II.nr.1759/2020, të dt.28.05.2020, e ka akuzuar N.A., se ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjyqtari i çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPK, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, e posaçërisht Raporti Policor 2020-AJ0163, dt:12.05.2020, Aktvendimi për ndalimin e personit të arrestuar me nr. 2020-AJ0163, dt:12.05.2020, Kallëzimi penal Nr.2020-AJ0-163, dt:13.05.2020, foto dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 të KPPK.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 par. 2, të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me taksën për progarmin e kompensimit të viktimave është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 31.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit – 05/L036.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**P.nr.1023/20, të datës 28.08.2020**

**G j y q t a r i**  
**Alban Ajvazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.